

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: Furnizim vendosje kaldaje

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**44621200-1 - Kaldaja, 45331110-0 - Instalime kaldajash**

VLERA E FONDIT LIMIT:

1.Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **32 500 000** (*tridhjetë e dy milion e pesëqind mijë*) **Lekë pa Tvsh.**

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është **324 254.2** (*treqind e njëzet e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër pikë dy*) **Euro pa Tvsh.** (*Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 30.07.2024 është 100.23 lekë.*)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**2.1.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçencë profesionale të shoqërisë, të lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihen të paktën kategoritë e mëposhtme:

**NS-12A** (Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 2, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, VKM nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “.....Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.....” Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e shërbimeve të pasqyruara në preventiv. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**2.1.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshir në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

**2.1.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. është kërkuar kjo certifikate pasi ofron një kuadër për menaxhimin efikas të shëndetit dhe sigurisë në punë përfshirë gjithë aspektet e menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore nga operatorë ekonomik, të cilët do të ekzekutojnë këto kontrata furnizimi. Një OE i certifikuar sipas këtij standardi është në gjendje të:

- Krijojë kushtet më të mira të punës në gjithë organizatën e tij;
- Identifikojë kërcënimet dhe vendos kontrollin për menaxhimin e tyre
- Redukton aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën joproduktive
- Përfshin dhe motivon stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune
- Dëshmon përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve

Të gjitha këto janë garanci se OE i shpallur fitues i cili është i certifikuar sipas këtij standardi ka kapacitetet e duhura për realizuar me sukses kontratat me AK-të. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**2.1.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 20000-1 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e e menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur certifikata ISO e kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të shërbimit. Kjo certifikatë specifikon kërkesat për një organizatë për të krijuar, zbatuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar vazhdimisht një sistem të menaxhimit të shërbimit (SMS). Kërkesat e specifikuara në këtë dokument përfshijnë planifikimin, projektimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve për të përmbushur kërkesat e shërbimit dhe për të ofruar vlerë. Ky dokument mund të përdoret nga:

- a) një klient që kërkon shërbime dhe që kërkon siguri në lidhje me cilësinë e këtyre shërbimeve;
- b) një klient që kërkon një qasje të qëndrueshme ndaj ciklit jetësor të shërbimit nga të gjithë ofruesit e tij të shërbimeve, duke përfshirë ata në një zinxhir furnizimi;

- c) një organizatë për të demonstruar aftësinë e saj për planifikimin, projektimin, kalimin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve;
- d) një organizatë për të monitoruar, matur dhe rishikuar SMS dhe shërbimet e saj;
- e) një organizatë për të përmirësuar planifikimin, projektimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve nëpërmjet zbatimit dhe funksionimit efektiv të një sistemi menaxhimi të shërbimit (SMS);
- f) një organizatë ose palë tjetër që kryen vlerësime të konformitetit kundrejt kërkesave të përcaktuara në këtë dokument;
- g) një ofrues trajnimi ose këshillimi në menaxhimin e shërbimeve.

Termi "shërbim" siç përdoret në këtë dokument i referohet shërbimit ose shërbimeve në objektin e SMS-ve. Termi "organizatë" siç përdoret në këtë dokument i referohet organizatës në fushën e SMS-ve që menaxhon dhe ofron shërbime për klientët. Organizata në fushën e SMS mund të jetë pjesë e një organizate më të madhe, për shembull, një departament i një korporate të madhe. Një organizatë ose pjesë e një organizate që menaxhon dhe ofron një shërbim ose shërbime për klientët e brendshëm ose të jashtëm mund të njihet gjithashtu si ofrues shërbimi. Çdo përdorim i termave "shërbim" ose "organizatë" me një qëllim të ndryshëm dallohet qartë në këtë dokument.

**2.1.5** Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur çertifikata e akreditimit e kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", VKM nr.667, datë 29.7.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit".

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që *bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"* i ndryshuar.

**2.2.2** Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të jetë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

*Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për Vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a), Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik Inxhinier mekanik/elektrik/elektronik për këtë objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Maj-Korrik 2024, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Licencë për Drejtues Teknik
- Diplomë
- Kontratë pune e vlefshme

**Shënim:** Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 11 (*njëmbëdhjetë*) punonjësve për periudhën Maj-Korrik 2024 dhe në vazhdim, të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Maj-Korrik 2024.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj-Korrik 2024.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesën e subjektit për periudhën Maj-Korrik 2024, specialistët si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Elektronik
- 1 (një) Informaticien

Për specialistët e lartë të mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme,
- Diplomë,
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj-Korrik 2024.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/ liçensuara ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Maj-Korrik 2024 dhe në vazhdim, minimumi:

- ❖ 3 (tre) punonjës specialistë për sistemet ngrohje/ftohje;
- ❖ 2 (dy) punonjës specialistë IT;
- ❖ 1 (një) punonjës specialist elektrikist.

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj-Korrik 2024.

- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/certifikatë e arsimit profesional).

***Shënim:** Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**Argumentimi për pikat 2.3.2, 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5;** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së furnizimit të mallrave, instalimit të tyre dhe punimeve ndihmëse që kërkohen të prokurohen siç janë shërbimet periodike për mirëmbajtjen e objekteve arsimore është e nevojshme pasja e një stafi teknik e vërtetuar kjo në bazë të kodeve të punësimit të profesioneve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, për realizimin me sukses të kontratës. Punonjësit e kualifikuar janë kërkuar duke u bazuar në numrin e objekteve në të cilat do të kryhen punimet si dhe natyrën dhe sasinë e punimeve që kërkohen. Me qëllim garantimin e realizimit të kontratës, stafi teknik inxhinierik dhe punonjësit e e kërkuar nga autoriteti kontraktor duhet të figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues. Përcaktimi që punonjësit nuk mund të kontraktohen nga operatori ekonomik ofertues enkas për këtë procedurë prokurimi vjen si rezultat i një përvoje 20-vjeçare të autoritetit kontraktor në fushën e shërbimit të mirëmbajtjes së objekteve arsimore ku kontraktimi për një numër të tillë punonjësish është i pamundur pasi përgjithësisht në kohën kur realizohet ky lloj shërbimi kërkesa e tregut të punës për këta punonjës është e madhe.

**2.3.2** Kriteri për të patur në stafin e operatorit ekonomik ofertues drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e shërbimeve. Detyrimi i administratorit të operatorit ekonomik ofertues për të përcaktuar me shkresë Drejtuesin Teknik të punimeve objekt të kontratës është bazuar në Ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimi duhet të ketë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj dhe VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

**2.3.3** Kërkesa për inxhinierët është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit. Është kërkuar **inxhinier mekanik** për zbatimin e punimeve të instalimit të mallrave në objekte në përputhje me zërat e pasqyruara në preventivit, termave të referencës dhe specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit. Inxhinieri mekanik është përgjegjës për zbatimin e saktë të preventivit për secilin nga zërat e punimeve të instalimit dhe për cilësinë e materialeve që vendosen

në objektet ku do të kryhen punimet. Është kërkuar **inxhinier elektrik** për faktin që natyra e punimeve të instalimit, për zërat kryesore të preventivit që është montimi dhe lidhja e paneleve elektrike e mallrave objekt prokurimi objekteve arsimore, prandaj rezulton se duhet patjetër që përzgjedhja dhe kombinimi i ngjyrave në sipërfaqe relativisht të mëdha të realizohet nga një specialist i kualifikuar. Është kërkuar **inxhinier elektronik dhe informaticien** për instalimin dhe vënien në punë të impiantit të kontrollit dhe monitorimit DMD (DIAGNOSTIC MONITORING DEVICE) për kryerjen e monitorimit, kontrollit dhe diagnostikimit në distancë të kaldajave. Nëpërmjet instalimit të sistemit të monitorimit dhe kontrollit në distancë të bëhet diagnostikimi, menaxhimi, automatizimi i sistemit termo-hidraulik, të bëhet kontrolli i gjëndjes së manometrave të presionit, të termostateve, paneleve elektrike- elektronike.

**2.3.4** Për sa i përket përcaktimit të punonjësve të kualifikuar nga institucione të arsimit profesional kjo kërkesë del e nevojshme nga shqyrtimi i prevetivit të pasqyruar ku sasia dhe lloji i shërbimeve e bëjnë të domosdoshëm vendosjen e këtij kriteri në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

- a) **3 (tre) punonjës specialistë për sistemet ngrohje/ftohje të kualifikuar** janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 3(tre) specialistë të kualifikuar duhet të jenë të pranishëm në punimet që do kryhen.
- b) **2 (dy) punonjës specialistë IT të kualifikuar** janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekte të ndryshme për instalimin dhe vënien në punë të impiantit të kontrollit dhe monitorimit DMD (DIAGNOSTIC MONITORING DEVICE) për kryerjen e monitorimit, kontrollit dhe diagnostikimit në distancë të kaldajave. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, dhe disa zëra të veçantë të preventivit realizimi i të cilave kërkon staf të specializuar është gjykuar që të paktën 1 (një) teknik ndërtimi i kualifikuar duhet të jetë i pranishëm në çdo objekt ku është i nevojshëm.
- c) **1 (një) punonjës specialist elektrikist i kualifikuar** është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 1 (një) specialist për punime gipsi i kualifikuar duhet të jetë pjesë e stafit teknik për realizimin e kontratës pasi natyra e punës me gipset kërkon aftësi profesionale të kualifikuara.

**2.3.5** Për sa i përket përcaktimit të numrit të përgjithshëm të punonjësve të nevojshëm për realizimin e kontratës jemi bazuar tek zërbërthimi i zërave preventivit, kohëzgjatja e kontratës dhe përcaktimi i orëve të punës të përlllogaritura në bazë të normativave të kryerjes së punimeve.

### 2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktet objekt prokurimi (kaldaja, djegës, enë zgjerimi, sistemi DMD). Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/ distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF), ose autorizim prodhuesi/ distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit (kaldaja, djegës, enë zgjerimi, sistemi DMD). Në rast paraqitje deklaratë furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kërkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kërkuara në DST. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë garancie 36 muaj për mallrat objekt të prokurimit (kaldaja, djegës, enë zgjerimi, sistemi DMD).

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe instalimi i kaldajave në objektet arsimore, të cilat duhet të realizohen

sipas specifikimeve teknike, duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që cilësia e mallit ndikon drejtpërdrejt në instalimin e pajisjeve në të cilat do të instalohen pasi nëse produkti nuk do të plotësonte minimalisht karakteristikat teknike të kërkuara ai do dëmtonte pajisjet teknike.

**2.3.9** Operatori ekonomik ofertues për realizimin në kohë të shërbimeve objekt të prokurimit duhet të ketë në pronësi ose me qira të paktën 1 (një) automjet kamion me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 (pesë) ton dhe 1 (një) automjet kamion vinç me kapacitet ngritës jo më pak se 5 (pesë) ton. Për vërtetimin e kësaj kërkesë duhet të paraqesë, Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin, Taksën e qarkullimit, Dokumentacionin teknik të vinçit ose në rast se nuk e ka automjetin në pronësi të paraqesë kontratën e qirasë si dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Taksën e qarkullimit, Kolaudimin,) të vlefshme.

*Shënim: Ky kriter (2.3.9) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe instalimi i kaldajave në objekte të shpërndara në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, automjetet e mësipërme konsiderohen të domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objekteve në të cilat do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për mallra të cilat janë të nevojshme për rritjen e cilësisë së kushteve në objektet arsimore. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Kërkesat për paketimet, etiketimet dhe dokumentacionin shoqërues të mallrave objekt prokurimi janë në përputhje me bazën

ligjore në fuqi, referuar Ligjit nr.10480 datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, Ligjit nr.10489 datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe Ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

*Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **PËR NJËSINË E PROKURIMIT**

- 1. Klodjan Llubani** \_\_\_\_\_
- 2. Gëzim Lipe** \_\_\_\_\_
- 3. Aida Shehaj** \_\_\_\_\_